

# Ligj për veprimtari të inovacionit

## TEKST I KONSOLIDUAR

Ligj për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/2013, 137/2013, 41/2014, 44/2015, 6/2016, 53/2016, 190/2016 dhe 64/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/2024).

### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Lënda

#### Neni 1

Në këtë ligj rregullohen veprimtaria e inovacionit, qëllimet dhe organizimi i zbatimit të rezultateve të veprimtarisë shkencore, hulumtuese, njohuritë teknike dhe teknologjike, zbulimet dhe inovacionet, si dhe themelimi, statusi, kompetencat, menaxhimi dhe udhëheqja, financimi, mbikëqyrja e punës, si dhe çështje tjera lidhur me punën e Fondit për Inovacione dhe Zhvillim të Teknologjive.

#### Zbatimi subsidiar

#### Neni 2

Në procedurat e përcaktuara me këtë ligj zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

#### Neni 3

Shprehjet e përdorura në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

- "Sistem nacional i inovacionit" është përmbledhja e organizatave, institucioneve dhe marrëdhëniet e tyre në funksion të gjenerimit, zgjerimit dhe zbatimit të rezultateve të veprimtarisë shkencore hulumtuese dhe përmirësimeve teknologjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- "Veprimtari e inovacionit" janë aktivitete të cilat merren që të krijohen inovacione të prodhimeve, teknologjive, proceseve dhe shërbimeve;
- "Inovacion" është zbatimi i prodhimit, teknologjisë, procesit ose shërbimit të ri ose dukshëm të përmirësuar, duke i përfshirë edhe specifikimet teknike, komponentët dhe materialet, softuerin e instaluar, orientimin ndaj shfrytëzuesve ose karakteristikave tjera

funkionale, metodën e marketingut ose metodën e re organizuese në punë, në organizimin e marrëdhënieve të punës ose marrëdhëniet e personit juridik me rrethinën;

4. "Inovacion i prodhimit" është aplikimi i prodhimit të ri ose dukshëm të përmirësuar, e nuk është ndryshim i natyrës estetike ose vetëm të shitjes së prodhimeve të inovacionit të prodhuara dhe zhvilluara nga personi tjetër fizik ose juridik;

5. "Inovacion i procesit" është zbatimi i mënyrës së re ose dukshëm të përmirësuar të prodhimeve ose dërgesave, depozitimit dhe transportit, duke përfshirë edhe ndryshimet e dukshme në teknikë, pajisje ose softuere, duke mos u kufizuar vetëm në ndryshime organizuese dhe menaxhuese;

6. "Inovacion i teknologjisë" është zbatimi i teknologjisë së re ose dukshëm të përmirësuar;

7. "Inovacion organizativ" është zbatimi i ndryshimeve të reja ose të dukshme në strukturë ose në metodat e menaxhimit, me qëllim të përmirësimit të përdorimit të njohurive, kualitetit të prodhimeve ose shërbimeve, ose rritjes së efikasitetit të proceseve afariste, në personin përkatës juridik ose hyrje në tregje të reja;

8. "Inovacion i marketingut" është zbatimi i metodave të reja të marketingjeve, duke përfshirë edhe ndryshimet e dukshme në dizajn, paketim, plasman dhe promovim të prodhimeve dhe arkëtimit të prodhimit;

9. "Inovacion i shërbimit" është zbatimi i shërbimit të ri dhe dukshëm të përmirësuar;

10. "Subjekt i veprimtarisë së inovacionit" është personi fizik ose juridik që krijon inovacione, plasojnë njohuri dhe teknologji të reja, në mënyrë origjinale dhe sistematike kryen zbatimin e rezultateve të reja dhe procese bashkëkohore teknologjike për krijimin e inovacioneve, zhvillimin e prototipave, prodhimeve, proceseve dhe shërbimeve të reja, ose përmirësimin e atyre ekzistuese në fushë të caktuar dhe është i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligjin për kryerjen e veprimtarisë së inovacionit;

11. "Subjekt për dhënie të mbështetjes infrastrukture për kryerje të veprimtarisë së inovacionit" është personi juridik për dhënie të mbështetjes infrastrukture dhe lidhje të organizatave shkencore hulumtuese me organizata të inovacionit dhe me subjekte ekonomike, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

12. "Inovator" është personi fizik i cili me veprimtarinë e vet inovative ka kontribuar për krijim të produkteve, teknologjive, proceseve dhe shërbimeve të reja ose mjaft të përmirësuara;

13. "Projekt i inovacionit" është dokument i cili propozon mënyra të realizimit të programeve nga veprimtaria e inovacionit, që rezulton me krijim të produkteve, teknologjive, proceseve dhe shërbimeve të reja ose të përmirësuara në mënyrë të konsiderueshme;
14. "Infrastruktura e inovacionit" është rrethi i krijuar në fushën e teknologjive informatike dhe të komunikimit, pajisja teknike teknologjike, infrastruktura fizike (hapësira, transporti, interneti dhe intraneti), si infrastruktura e njohurisë (resurse të institucioneve shkencore hulumtuese dhe resurse tjera arsimore dhe konsultuese), që është në funksion të nxitësit të ristrukturimit të sektorit afarist dhe rrjetëzimit të subjekteve të veprimtarisë së inovacionit në sektorin akademik dhe ekonomik;
15. "Shoqëri tregtare më e vogël, e vogël dhe e mesme e sapo themeluar start-up" është shoqëria e themeluar nga një ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, nga themelimi i së cilës, deri në momentin e aplikimit për financim nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk kanë kaluar më shumë se gjashtë vite;
16. "Shoqëri tregtare e sapo themeluar spin-off" është shoqëria tregtare e themeluar nga një ose më shumë persona fizikë të punësuar/angazhuar ose studente në institucione që kryejnë veprimtari të arsimit të lartë, përkatësisht veprimtari shkencore hulumtuese dhe/ose nga subjekte ekonomike, me qëllim eksplotimi komercial të inovacionit, të bartur në shoqërinë e sapo themeluar tregtare;
17. "Grante të kofinancuara" janë grante ku pranuesi i grantit doemos duhet të marrë pjesë me mjete personale në shumë prej minimum 15% të investimit të përgjithshëm;
18. "Ekviti investim" është investimi në shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe tregtar individ me të cilin blihet pjesëmarrja ekzistuese nga pronësia e shoqërisë tregtare që kryen veprimtari të inovacionit në pajtim me këtë ligj ose investimi me të cilin merret pjesëmarrja e re në atë shoqëri tregtare;
19. "Mezanin investim" është investim që i ka karakteristikat edhe të ekuiti investimit dhe të kreditimit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe tregtarit individ që kryen veprimtari të inovacionit në pajtim me këtë ligj;
20. "Fond për ekuiti dhe mezanin investime" paraqet pronë të veçantë, pa veti të personit juridik, i formuar për përkrahje të veprimtarisë inovative nëpërmjet grumbullimit të mjeteve nga investitorët, për realizim të instrumentit ekuiti dhe mezanin investim dhe
21. "Të hyra (rojallti)" është kompensim të cilin e merr Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik në bazë të realizimit të projekteve për inovacione ose transfer të teknologjive,

kurse zhvillimin e të cilave e ka financuar Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik, në pajtim me marrëveshje për financim.

## **Veprimtaria e inovacionit**

### **Neni 4**

Veprimtaria e inovacionit i përfshin aktivitetet në vijim:

- aplikimin e punës shkencore hulumtuese dhe aktivitetet teknologjike, në drejtim të krijimit të produkteve, shërbimeve dhe proceseve të reja ose të përmirësuara, risive ose përmirësimeve në procesin teknologjik, të implementuara në qarkullimin ekonomik;
- pajisjen teknologjike dhe përgatitjen e prodhimtarisë për veprimtari të inovacionit,
- testimin për certifikim dhe standardizim të produkteve, teknologjive, proceseve dhe shërbimeve të reja,
- krijimin e produkteve dhe shërbimeve të reja ose të përmirësuara dhe/ose aplikimin e teknologjive të reja ose të përmirësuara në periudhën fillestare të projektit të inovacionit,
- organizimin dhe/ose rregullimin e tregjeve të produkteve, teknologjive, proceseve dhe shërbimeve të inovacionit,
- transferin e teknologjive dhe/ose njohurive për produkte, teknologji, procese dhe shërbime të inovacionit,
- krijimin dhe zhvillimin e infrastrukturës për inovacione,
- mbrojtjen, transferimin dhe marrjen e të drejtave nga inovacionet, me qëllim të zhvillimit dhe komercializimit të tyre,
- përdorimin e ideve dhe rezultateve të reja të veprimtarisë shkencore hulumtuese në fushën e menaxhimit me shoqërinë,
- promovimin e rezultateve nga aktiviteti të inovacionit dhe komercializimin e rezultateve nga veprimtaria të inovacionit,
- miratimin dhe aplikimin e know-how globale teknologjike,
- përshtatjen e diturisë globale intelektuale në nivel të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- aktivitete tjera drejt krijimit të inovacioneve, në pajtim me këtë ligj.

## **Politika e inovacionit**

### **Neni 5**

Për vendosjen e qëllimeve dhe sigurimit të kushteve sistemore për krijim, zhvillim dhe implementim të inovacioneve, Qeveria e Republika e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) miraton Strategji për inovacione për periudhë prej shtatë vitesh, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Punës.

## Komiteti për inovacione dhe sipërmarrësi

### Neni 6

Qeveria formon Komiteti për inovacione dhe sipërmarrësi (në tekstin e mëtejme: Komiteti).

Komiteti përbëhet prej kryetarit dhe 16 anëtarëve.

Kryetar i Komitetit është Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Anëtarë të komitetit janë:

- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Financave,
- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Shëndetësisë,
- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Ekonomisë dhe i Punës,
- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Transformimit Digjital,
- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës,
- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Politikës Sociale, i Demografisë dhe i Rinisë,
- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor,
- dy ministra pa resorë,
- ministri, përkatësisht zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe
- pesë ekspertë për veprimtari të inovacionit që i propozon Qeveria.

Komiteti i kryen punë në vijim:

- koordinim të politikave dhe masave të Qeverisë për rritje të inovacionit dhe konkurrencës,
- qasje të integruar në krijimin dhe implementimin e aktiviteteve dhe masave për rritje të inovacionit dhe konkurrencës,
- koordinim të shpërndarjes së mjeteve buxhetore në pajtim me prioritetet e Qeverisë,
- i shqyrton raportet e punës së Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik,
- koordinim ndërmjet institucioneve në krijimin e politikave dhe zbatimit të aktiviteteve për inovacione dhe konkurrencë, për t'u pamundësuar përputhja e të njëjtave në institucione të ndryshme,
- shqyrtim dhe dhënie të mendimit për programet e Fondit, para dërgimit në Qeveri,
- dhënie të rekomandimeve/propozimeve në Qeveri lidhur me programet dhe projektet nga organizatat ndërkombëtare për mbështetje dhe zhvillim të veprimtarisë së inovacionit,
- përcjellje të rregullt të politikave dhe masave të Bashkimit Evropian dhe shteteve me praktiken më të mirë në fushën e rritjes së inovacioneve dhe vlerësim të relevancës dhe ndikimit të tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- dhënie rekomandime dhe propozime ministrive në temën e inovacioneve lidhur me

veprimtaritë e tyre,

- dhënie rekomandime dhe propozime në Qeveri si mund të zbatohen aktivitetet për zhvillim të teknologjisë me qëllim të rritjes, komercializimit dhe absorbimit të inovacioneve,
- përcjellje e rregullt e indikatorëve për inovacione të ekonomisë maqedonase sipas Indeksit global të inovacioneve, e në këtë bazë ndërtim i qëndrimeve përkatëse dhe propozim i masave,
- dhënie rekomandime dhe propozime në Qeveri lidhur me rrethin afarist, e në lidhje me pronësinë intelektuale dhe lehtësim i financimit të inovacioneve,
- qasje e integruar në krijimin e politikave për trupat implementues/agjencitë dhe dhënie të propozimeve përkatëse në Qeveri për zgjerim të kompetencave të trupave ekzistues/agjencive dhe/ose formimin e të rejave nga fusha e inovacioneve dhe
- punë tjera në lidhje me realizimin e detyrave dhe qëllimeve për veprim të Komitetit.

Komiteti miraton rregullore për punën e vet.

## **Neni 7**

Me propozim të Komitetit Qeveria mund të formojë trupa të veçante për përcjellje dhe stimulim të veprimtarisë së inovacionit në fusha të veçanta dhe degë të veçanta ekonomike, me qëllim që ta koordinojë punën, t'i realizojë interesat e përbashkëta në fushën e veprimtarisë së inovacionit.

## **Kompetenca të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës**

### **Neni 8**

Për përcjellje të zhvillimit dhe eksplotimit komercial të inovacioneve Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përmes Seksioni për inovacione dhe sipërmarrësi (në tekstin e mëtejme: Seksioni), i kryen punë në vijim:2

- përgatit strategji për inovacione,
- i përgatit planet trevjeçare aksionale që rezultojnë nga Strategjia për inovacione,
- i propozon Komitetit dhe Qeverisë politikë në fushën e veprimtarisë së inovacionit dhe programe të veprimtarisë së inovacionit,
- i përcjell dhe analizon tendencat dhe standardet evropiane dhe botërorë në veprimtarinë e inovacionit dhe propozon masa për inkorporimin e tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- i përcjell dhe analizon çështjet e lidhura me inovacionet siç është pronësia intelektuale dhe ekspansioni i teknologjisë, si në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe trendët botërore dhe propozon masa për t'u përgjigjur sfidave dhe mundësive të këtyre ndryshimeve,
- e përcjell realizimin e aktiviteteve ekzistuese në veprimtarinë e inovacionit dhe propozon

masa në pajtim me potencialin zhvillimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- jep mendime dhe propozime për veprimtari të inovacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- jep mendime, propozime dhe udhëzime për bashkëpunim ndërkombëtar, realizon bashkëpunim ndërkombëtar dhe kujdeset për përfshirjen e bartësve të veprimtarisë së inovacionit në hapësirën evropiane dhe ndërkombëtare, në pajtim me këtë ligj dhe e analizon praktikën ndërkombëtare në këtë fushë,
- i propozon Komitetit indikatorë konkrete për përcjellje dhe evaluim për programe të inovacionit duke përfshirë edhe shërbime për zhvillim të teknologjive,
- kryen analizë të efektivitetit të programeve dhe rekomandimeve të ndryshme në Komitet dhe Qeveri për përmirësim të ndikimit të iniciativave ekzistuese dhe të propozuara,
- përgatit analiza profesionale në fushën e veprimtarisë së inovacionit,
- zbaton hulumtime, sondazhe dhe kërkime ekonomike dhe teknologjike me qëllim të ndihmës Qeverisë, për përmirësimin e politikës për ndihmë të veprimtarisë inovative,
- Inicion ndryshime të ligjeve dhe dispozitave tjera në këtë fushë, me qëllim të stimulimit të veprimtarisë së inovacionit,
- e stimulon bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe industrisë dhe ndihmon gjatë orientimit të arsimit në sfera dhe shkathtësi, ku ka kërkesë të tregut, e të njëjtën e bën përmes lehtësimit të interaksionit ndërmjet konzorciumeve të ndryshe industriale, bashkësisë akademike dhe bashkësisë së inovacionit, nëpërmjet takimeve të rregullta,
- i përcjell programet e ndryshme të Bashkimit Evropian për inovacione dhe hapësirën e inovacionit të komercializimit dhe i hulumton mundësitë që të marrin pjesë në to me marrje të hapave për plotësim të kërkesave për pjesëmarrje, e me këtë të ndihmojë për shkallë të lartë të shfrytëzimit të mjeteve nga ato programe,
- ndihmon gjatë zbatimit të trajnimeve për përfundim të kapaciteteve për kryerje të veprimtarisë së inovacionit,
- ndihmon gjatë vendosjes së infrastrukturës teknologjike, me qëllim që një sektor i caktuar industrial ose industri, si tërësi të ketë dobi, në sfera që për momentin nuk ekzistojnë e janë të nevojshme,
- mban bazë elektronike të të dhënave të veprimtarisë së inovacionit dhe
- parashtron në Komitet dhe në Qeveri raport për situatën dhe rezultatet nga veprimtaria e inovacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më së voni deri më 31 janar, për vitin e kaluar.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës për realizimin e aktiviteteve nga paragrafi 1 alinetë 16 dhe 17 të këtij neni miraton program, me pëlqim paraprak të Qeverisë.

Mjetet për aktivitetet nga paragrafi 1 alinetë 16 dhe 17 të këtij neni Ministria e Arsimit dhe Shkencës i ndan nëpërmjet konkursit publik.

Mënyrën e ndarjes së mjeteve nga paragrafi 3 i këtij neni i përcakton ministri i Arsimit dhe Shkencës, pas mendimit pozitiv paraprak të Komitetit.

## II. SUBJEKTE PËR DHËNIE TË MBËSHTETJES INFRASTRUKTURORE PËR KRYERJE TË VEPRIMTARISË SË INOVACIONIT

### Neni 9

Subjekti për dhënie të mbështetjes infrastrukturore për kryerje të veprimtarisë së inovacionit, regjistrohet në bazën elektronike në Ministrinë si:

- akselerator afarist teknologjik,
- park shkencor teknologjik dhe
- subjekt për stimulim të aktiviteteve të inovacionit në fushat prioritare nga shkenca dhe teknologjie dhe
- qendra për transfer të teknologjive.
- Zyra Nacionale për Transfer të Teknologjive

### Neni 10

#### *I fshirë3*

### Akseleratori afarist teknologjik

### Neni 11

Akseleratori teknologjiko-afarist është subjekt për dhënien e mbështetjes infrastrukturore të veprimtarisë inovative që e përshpejton rritjen e suksesshme të start-ap ndërmarrjeve në fazën e tyre të hershme të zhvillimit nëpërmjet sigurimit të start ap ndërmarrje me varg të resurseve të nevojshme dhe shërbimeve, kurse para se gjithash nëpërmjet investimeve dhe fitimit të pronësisë në të njëjtat, me qëllim të rritjes së start-ap ndërmarrjeve në nivel nacional ose global.

Periudha e ofrimit të shërbimeve të akseleratorit afarist nuk duhet të jetë më i gjatë se gjashtë muaj duke filluar nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes nga paragrafi 3 i këtij neni.

Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni periudha e ofrimit të shërbimeve të akseleratorit teknologjiko-afarist mund të jetë edhe më gjatë se gjashtë muaj në rast të investimit në start-ap ndërmarrje.

Të drejtat dhe obligimet e shfrytëzuesve të shërbimeve dhe të inkubatorit afarist teknologjik rregullohen me marrëveshje të ndërsjellë.

Të gjitha subjektet që shfrytëzojnë shërbime të akseleratorit afarist teknologjik marrin status të shfrytëzuesit të akseleratorit afarist teknologjik.

Akseleratori afarist themelohet dhe vepron si person juridik në pajtim me Ligjin për shoqëri dhe fondacione dhe/ose Ligjin për shoqëri tregtare.

Nëse akseleratori afarist themelohet dhe vepron si person juridik në pajtim me Ligjin për shoqëri dhe fondacione, mund t'i ndahet status i organizatës me interes publik.

## **Parku shkencor teknologjik**

### **Neni 12**

Parku shkencor teknologjik është subjekt për dhënie të mbështetjes infrastrukturore veprimtarisë së inovacionit që në suazat e hapësirës me të cilën menaxhon, u mundëson shërbime infrastrukturore dhe profesionale subjekteve të veprimtarisë së inovacionit, me qëllim të lidhjes, krijimit dhe aplikimit sa më të shpejte të teknologjive të reja, krijim dhe plasman të produkteve të reja, procese dhe shërbime në treg.

Të gjitha subjektet që shfrytëzojnë shërbime të parkut teknologjik shkencor, marrin status të anëtarit të parkut shkencor teknologjik, të cilave parku shkencor teknologjik në një apo më shumë lokacione u mundëson kushte hapësinore dhe infrastrukturore për punë dhe njëkohësisht mundëson shërbime tjera për rritjen e nivelit të punës shkencore hulumtuese, arsimit të lartë, zhvillimore, të inovacionit ose prodhuese.

Parku shkencor teknologjik anëtarit të vet mund t'i mundësojë përdorim të pjesës së truallit, në kuadër të parkut shkencor teknologjik, për ndërtim të kapaciteteve zhvillimore dhe prodhuese, e në pajtim me veprimtarinë themelore të parkut shkencor teknologjik.

Parku shkencor teknologjikë themelohet dhe vepron si person juridik në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare.

Të drejtat dhe obligimet ndërkombëtare të anëtarit dhe parkut shkencor teknologjike rregullohen me marrëveshje.

## **Subjekti për nxitje të aktiviteteve të inovacionit në fushat prioritare të shkencës dhe teknologjisë**

### **Neni 13**

Subjekt për nxitje të aktiviteteve të inovacionit në fushë prioritare të shkencës dhe teknologjisë është personi juridik i themeluar për kryerje të veprimtarisë, nxitje të

aktiviteteve të inovacionit në fusha prioritare të shkencës dhe teknologjisë, të përcaktuara me Strategjinë për inovacione.

Subjekti nga paragrafi 1 i këtij neni themelohet dhe vepron si person juridik në pajtim me Ligjin për shoqëri dhe fondacione dhe/ose Ligjin për shoqëri tregtare.

Subjekte aktivitetet e të cilave janë të lidhura me mbështetje të inovacioneve dhe/ose komercializim të inovacioneve dhe pronësisë intelektuale, duke përfshirë dhe zhvillimin e teknologjive.

## **Qendra për transfer të teknologjive**

### **Neni 14**

Qendër për transfer të teknologjive është personi juridik i themeluar nga institucioni i arsimit të lartë përkatësisht, shkencor hulumtues ose nga personi tjetër fizik përkatësisht personi juridik në bashkëpunim me institucionin e arsimit të lartë dhe shkencor hulumtues, për kryerje të veprimtarisë së transferit të teknologjive për aplikim të inovacioneve teknologjike, vlerësim të potencialit komercial nga transferi, nxitje për realizim dhe komercializim të transferit të teknologjive, mbrojtje të pronësisë intelektuale, sigurim të mjeteve kapitale në fazë të hershme të zhvillimit dhe ndihmë subjekteve të veprimtarisë së inovacionit.

Qendra për transfer të teknologjive themelohet dhe vepron si person juridik në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe/ose Ligjin për shoqata dhe fondacione .

## **Zyra Nacionale për Transfer të Teknologjive**

### **Neni 14-a**

Zyra Nacionale për Transfer të Teknologjive (në tekstin e mëtejshëm: Zyra nacionale) është person juridik e themeluar nga institute, institucione të arsimit të lartë përkatësisht institucione shkencore-hulumtuese, oda ekonomike, fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik respektivisht persona tjerë juridikë nga sfera e inovacioneve, për lidhje të sektorit për arsim të lartë me industrinë, e cila do t'i promovojë aktivitetet inovative të hulumtimeve dhe kompanive.

Zyra nacionale do të kryejë transfer të teknologjive dhe shërbime tjera në lidhje me udhëheqjen me marrëveshje për hulumtim, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe industrisë, përkrahje të universiteteve dhe industrisë për aktivitete lidhur me teknologjinë dhe pronësinë intelektuale.

Zyra nacionale themelohet dhe vepron si person juridik në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione.

### **Neni 15**

Republika e Maqedonisë së Veriut, njësitë e vetadministrimit lokal, shoqëritë tregtare, institucionet shkencorë hulumtuese dhe arsimore, persona tjerë juridike dhe fizike, në pajtim me këtë ligj, mund të jenë themelues të subjekteve për dhënie të mbështetjes infrastrukturore për kryerje të veprimtarisë së inovacionit.

## **III. BAZA ELEKTRONIKE E TË DHËNAVE TË VEPRIMTARISË SË INOVACIONIT**

### **Neni 16**

Ministria mban bazë elektronike të të dhënave për veprimtari të inovacionit (në tekstin e mëtejshëm: baza).

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së bazës i përcakton ministri.

Në bazë regjistrohen subjekte të veprimtarisë së inovacionit, si dhe subjekte për dhënie të mbështetjes infrastrukturore për kryerje të veprimtarisë së inovacionit.

Baza nga paragrafi 1 i këtij neni i përmban: të dhëna për subjektet që janë shfrytëzues të masave nxitëse ekonomike dhe mjeteve buxhetore për zhvillim të veprimtarisë së inovacionit, si dhe titullin e projektit, lartësinë e mjeteve të ndara dhe shfrytëzueshmëri e tyre dhe abstraktin e projektit, raportin për qëllimet e planifikuara teknologjike dhe arritjet.

Për regjistrim në bazën e subjekteve nga paragrafi 3 i këtij neni parashtrojnë kërkesë me dokumentacionin e duhur.

Subjektet nga paragrafi 4 i këtij neni regjistrohen në bazën me detyrë zyrtare.

Ministria, nëse janë plotësuar kriteret nga neni 17 i këtij ligji, lëshon aktvendim për regjistrim të subjektit nga paragrafi 3 i këtij neni në bazë, në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së parashtruar nga personi juridik.

Subjekti i regjistruar në bazë do të shlyhet nëse e ndërprejnë plotësimin e kriterëve nga neni 18 i këtij ligji.

Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi 5 i këtij neni dhe dokumentacionin e duhur i përcakton ministri.

Të dhënat nga baza, Ministria i parashtron në Entin Shtetëror për Statistikë, më së shumti deri më 31 janar për vitin paraprak.

## **Kritere themelore dhe më të afërta për regjistrim në bazë**

### **Neni 17**

Kritere themelore për regjistrim të subjekteve nga neni 16 paragrafi 3 i këtij ligji që persona juridike, janë:

- të kenë seli në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të jenë të themeluar në pajtim me ligjin dhe të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të kenë akt të përgjithshëm me të cilin përcaktohen qëllimet e themelimit, përkatësisht qëllimet programore në fushën e veprimtarisë së inovacionit dhe
- të kenë plan dhe program për aktivitete të inovacionit në drejtim të fuqizimit të konkurrencës së ekonomisë maqedonase dhe përmirësim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, për periudhë prej së paku një viti.

Kritere themelore për regjistrim të subjekteve nga neni 16 paragrafi 3 i këtij ligji që janë persona fizikë, janë:

- të kenë vendbanim, përkatësisht qëndrim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të kenë plan dhe program për aktivitete të inovacionit në drejtim të fuqizimit të konkurrencës së ekonomisë maqedonase dhe përmirësim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, për periudhë prej së paku një viti.

Kriteret për regjistrimin e subjekteve në bazën më të përafërt do të përshkruaj ministri.

Kriteret për regjistrim të subjekteve në bazë më afërsisht i përcakton ministri.

### **Neni 18**

Të gjitha subjektet që mbahen në bazë dhe janë shfrytëzues të masave nxitëse shtetërore dhe mjeteve buxhetore për zhvillimin e veprimtarisë së inovacionit, janë të obliguar që për punën e tyre, gjendjen e pajisjes dhe resurset, si dhe për planet e shfrytëzimit të tyre, të parashtrojnë raport vjetor te Ministria më së voni deri më 28 shkurt për vitin paraprak.

Përmbajtjen e raportit vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri.

## **IV. FINANCIMI I VEPRIMTARISË SË INOVACIONIT**

### **Neni 19**

Republika e Maqedonisë së Veriut dhe njësitë e vetadministrimit lokal mund të sigurojnë financimin e veprimtarisë të inovacionit për arritjen e qëllimeve të politikës së inovacionit.

Mjetet për financimin e veprimtarisë së inovacionit sigurohen nga:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- buxhetet e njërive të vetadministrimit lokal,
- organizatat ndërkombëtare financiare,
- fondi për veprimtari të inovacionit dhe zhvillim teknologjik;
- Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural
- fonde tjera dhe
- masa nxitëse ekonomike në pajtim me nenin 45 të këtij ligji.

## **Ndihma shtetërore**

### **Neni 20**

Për mjetet të cilat akordohen në bazë të këtij ligji aplikohen dispozitat nga sfera për kontroll të ndihmës shtetërore.

## **V. FONDI PËR INOVACIONE DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK**

### **Neni 21**

Me qëllim të sigurimit të mjeteve financiare për nxitjen e veprimtarisë së inovacionit, themelohet Fond për inovacione dhe zhvillim teknologjik (në tekstin e mëtutjeshëm: Fondi).

Fondi ka cilësi të personit juridik.

Selia e Fondit është në Shkup.

Emri i Fondit në qarkullimin ndërkombëtar juridik është “Fund for innovations and technology development“.

### **Statuti**

### **Neni 22**

Fondi ka statut, rregullore dhe akte tjera të përgjithshme në pajtim me ligjin.

Statutin e miraton Këshilli Drejtues i Fondit, me pëlqim paraprak nga Qeveria.

Me statutin e Fondit rregullohen: organizimi dhe mënyra e punës së Fondit, mënyra e propozimit të përfaqësuesve të punësuar në organet e Fondit, kompetenca e Këshillit Drejtues dhe Komitetit për Aprovimin e Investimeve, përfaqësimi dhe prezantimi i Fondit, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në Fond, mënyra e organizimit të punëve dhe çështje tjera me rëndësi për punën e Fondit.

Rregulloret nga paragrafi 1 i këtij neni i miraton Këshilli Drejtues i Fondit, me pëlqim paraprak nga Qeveria.

## **Punët e Fondit**

### **Neni 23**

Fondi kryen punë të lidhura me financimin e përgatitjes, realizimit dhe zhvillimit të programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera nga sfera e zbatimit të politikës së inovacionit, e në veçanti:

- punë profesionale dhe punë tjera në lidhje me sigurimin e mjeteve në Fond, menaxhim me ato mjete dhe shfrytëzimin e tyre,
- zbatimi i programeve, projekteve dhe ndërmjetësimi në lidhje me financimin e veprimtarisë së inovacionit nga mjetet e organizatave ndërkombëtare, institucionet financiare dhe trupat, organe të administratës shtetërore, organe shtetërore, agjenci ose ndërmarrje publike, si dhe persona fizik dhe juridik vendas dhe të huaj, veçanërisht në sferat e veprimtarisë së inovacionit, shkencës dhe teknologjisë në pajtim me prioritet e përcaktuar në strategjinë për inovacione,
- evidencë së të dhënave për shfrytëzuesit e mjeteve të ndara nga Fondi,
- nxitjen dhe krijimin e bashkëpunimit me institucione financiare ndërkombëtare dhe të vendit dhe persona tjerë fizikë dhe juridikë, për financim të veprimtarisë së inovacionit, në pajtim me politikën e inovacionit dhe planet dhe programet tjera strategjike, si dhe me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare për dedikime të përcaktuara me këtë ligj,
- themelon Fond për ekuiti dhe mezanin investime,
- zgjedh shoqëri për menaxhim me fonde private nëpërmjet thirrjes publike, e cila do të menaxhojë me mjetet e Fondit të dedikuara për realizim për instrumentet për investime ekvite dhe mezanin dhe
- pjesëmarrje në themelimin e Zyrës Nacionale për Transfer të Teknologjive, për përkrahje dhe nxitje të bashkëpunimit të universiteteve me industrinë dhe
- kryen ndjekjen dhe evaluimin e projekteve për të cilat janë ndarë mjete, me qëllim të zhvillimit të shoqërisë sipërmarrëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të dhënat nga paragrafi 1 alineja 3 të këtij neni, Fondi i dorëzon te Enti Shtetërorë për Statistike më së voni deri më 31 janar, për vitin paraprak.

Për shkak të ngritjes së vetëdijes publike për rëndësinë e veprimtarisë inovative në Republikën e Maqedonisë së Veriut, promovim të instrumenteve për përkrahje, si dhe përforsim të marrëdhënieve me publikun, Fondi mund të organizon zyra.

## **Sfera të veprimit të Fondit**

### **Neni 24**

Fondi zhvillon dhe kryen shërbime dhe ndan mjete financiare në pajtim me Strategjinë për inovacione dhe programet për punën e Fondit nga neni 29 të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me këto sfera:

- ndarje të mjeteve financiare për projekte inovative për rritje të shoqërive të sapothemeluara tregtare, start ap dhe spin of ndërmarrjeve,
- ndarjen e grandëve të kofinancuara dhe huave të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve,
- ndarje të granteve të kofinancuara për transfer të teknologjive me qëllim të konkurrencës më të madhe të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme,
- ndarje e granteve të kofinancuara për ekstension teknologjik me qëllim të konkurrencës më të madhe, të ndërmarrjeve mikro, të mesme dhe të vogla,
- stimulim të vendosjes ose rritjes së akseleratorëve teknologjiko-afaristë nëpërmjet ndarjes së granteve të kofinancuara,
- ndarje të ndihmës teknike për ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme,
- nxitjen e investimeve private dhe financimin e projekteve zhvillimore dhe/ose të inovacionit në të gjitha fazat e zhvillimit nëpërmjet kapitalit personal dhe nëpërmjet kombinimit të kapitalit personal dhe kredive, nëpërmjet sigurimit të burimeve të volitshme të kredisë dhe nëpërmjet skemave për koinvestim me investitorër dhe fonde investuese dhe
- investim të mjeteve me qëllim të përkrahjes së fondeve ekzistuese dhe formimin e fondeve të reja private me prospekt ose strategji për investim në ndërmarrje të cilat janë në pajtim me lëndën e punës dhe kompetencat e Fondit.

## **Instrumente për mbështetje**

### **Neni 25**

Fondi ndan mjete nëpërmjet instrumenteve për mbështetje, si vijon:

- grande të kofinancuara për shoqëri tregtare të sapo themeluara start-ap dhe spin-of,
- grande të kofinancuara dhe hua të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve,
- investime ekvite dhe mezanin,
- grante të kofinancuara për vendosjen, punën dhe investimet e akseleratorëve dhe eknologjikë-afaristë,<sup>4</sup>
- grante të kofinancuara për ekstension teknologjik

- grandë të kofinancuara për transfer të teknologjive,
- ndihmë teknike dhe
- skema për koinvestim me investitorë dhe fonde investuese.

Nëse mjetet të cilat ndahen përmes instrumenteve të theksuara në paragrafin 1 nga ky nen janë siguruar nga të hyra në pajtim me nenin 26 paragrafi 1 alineja 3 të njëjtat realizohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe me rregullat nga sfera e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Fondi ndan mjete nëpërmjet konkursit publik të shpallur, në bazë të kriterëve në vijim:

1. Për instrumentet: Grante të kofinancuara për shoqëri tregtare të sapothemeluara start ap dhe spin of, Grante të kofinancuara dhe hua të kushtëzuara për komercializim të inovacioneve dhe ndihmë teknike:

- shkallë e inovacionit,
- cilësi e projektit,
- kapacitet i ekipit të projektit,
- potencial i tregut dhe
- ndikim.

2. instrumentet Grante të kofinancuara për transfer të teknologjive, Grante të kofinancuara për ekstension teknologjik:

- bashkëpunim,
- përmirësim teknologjik,
- cilësi e projektit,
- kapacitet i ekipit të projektit,
- potencial i tregut,
- ndikim dhe
- procedura për sigurim të cilësisë, standardizim dhe certifikim.

3. Për instrumentet Grante të kofinancuara për themelim, punë dhe investime të akseleratorëve dhe inkubatorëve teknologjiko-afaristë dhe Mezanin dhe ekuiti investime:

- profil i ekipit menaxherial dhe të resurseve njerëzore,
- cilësi e projektit,
- kapacitete institucionale dhe qëndrueshmëri,
- parametra financiarë dhe
- relevancë e buxhetit.

Kriteret më të përafërta për ndarjen e mjeteve nga paragrafi 3 i këtij neni dhe mënyrën për ndarjen e mjeteve, përmbajtjen e konkursit publik për ndarjen e mjeteve, mënyrën e vlerësimit të fletëparaqitjeve të parashtruara, mënyrën e promovimit dhe procedurat tjera në lidhje me akordimin e mjeteve nga instrumentet e Fondit i përcakton Fondi, me pëlqim paraprak të Qeverisë.

Për mjetet e ndara nga paragrafi 1 i këtij neni, Fondi me shfrytëzuesin e mjeteve lidh marrëveshje.

## Neni 25-a

Gjatë evaluimit dhe vendimmarrjes për projektet e paraqitura në konkurs publik, Fondi mund të angazhojë persona profesionalë nga Regjistri i personave profesionalë nga sfera përkatëse të bëjnë evaluim dhe të japin mendim profesional.

Personi profesional është i obliguar ta shqyrtojë materialin dhe të dorëzojë evaluim dhe mendim profesional në afat prej shtatë ditë pune nga dita e marrjes së materialit.

Në shtesë të mendimit të vet, personi profesional dorëzon deklaratë nën përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale se mendimi është punuar në mënyrë profesionale dhe me vetëdije, në pajtim me rregullat e shkencës dhe profesionit, normat etike dhe profesionale dhe se nuk do të marrë pjesë, në mënyrë direkte ose indirekte, në procedurë për ndarjen e marrëveshjes për grant, që është lëndë e kërkesës për evaluim.

Personat profesionalë kanë të drejtë të kompensimit për evaluimin e bërë dhe mendimin e dhënë profesional që është në ngarkim të Fondit në shumë që përcaktohet me listë tarifore që e miraton Këshilli Drejtues i Fondit, kurse me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 4 të këtij neni përcaktohet sipas, vlerësimit të përcaktuar të marrëveshjes.

Mënyra e përfshirjes dhe puna e personave profesionalë në punën e Fondit gjatë evaluimit dhe dhënia e mendimit profesional rregullohet me rregullore të cilën e miraton Këshilli Drejtues i Fondit.

Fondi themelon dhe mban Regjistër elektronik të personave profesionalë të cilët i ndihmojnë gjatë evaluimit dhe dhënies së mendimit profesional. Të dhënat personale të personave profesionalë të cilët do të evidentohen në Regjistrin e personave profesionalë janë: emri dhe mbiemri, data dhe vendlindja, shtetësia, adresa e jetesës, kontakt telefoni, adresa elektronike, sfera e specializimit, të dhëna për arsim të mbaruar dhe përvojë pune. Afati për ruajtjen e të dhënave personale është tre vjet duke llogaritur nga dita e njoftimit për shlyerje nga Regjistri i personave profesionalë.

Për regjistrim në Regjistrin e personave profesionalë Fondi publikon thirrje publike në të cilën përcaktohen sferat e specializimit, kushtet për zgjedhje, mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjeve, dokumentacioni i nevojshëm për dëshmimin e plotësimin të kushteve për zgjedhjen e elementeve tjera që i përcakton Këshilli Drejtues i Fondit.

Regjistrimi në Regjistrin e personave profesionalë kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të parashtruar te Fondi me të cilën dorëzohen edhe prova për plotësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 10 të këtij neni.

Që të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë, personi duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të ketë së paku arsim të lartë në sferën përkatëse,
- të ketë njohje të gjuhës angleze,
- të ketë së paku shtatë vjet përvojë pune në sferën përkatëse për të cilën është parashtruar kërkesa.

Përvoja ndërkombëtare në sferën e specializimit dhe përvoja në zbatimin e analizës esenciale do të konsiderohet përparësi gjatë regjistrimit në Regjistrin e personave profesionalë.

Drejtori i Fondit formon Komision për zgjedhjen e personave profesionalë nga së paku tre nga radhët e të punësuarve nga të cilët njëri është kryetar, i cili e përcakton plotësimin e kushteve për regjistrim nga paragrafi 10 të këtij neni dhe dorëzon propozim te drejtori i cili miraton vendim për zgjedhjen dhe regjistrimin e personave profesionalë në Regjistër.

Para lidhjes së marrëveshjes me personat profesionalë dhe regjistrimin e tyre në Regjistrin e personave profesionalë, Komisioni për zgjedhjen e personave profesionalë mund të zbatojë kontroll plotësues dhe intervistë me kandidatët e paraqitur.

Personat profesionalë regjistrohen në Regjistrin për persona profesionalë sipas sferave të specializimit të cilat i përcakton Këshilli Drejtues i Fondit. Një person mund të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë në më shumë sfera të specializimit.

Drejtori i Fondit formon Komision për shlyerjen e personave profesionalë nga më së paku tre nga radhët e të punësuarve nga të cilët njëri është kryetar, i cili e përcakton plotësimin e kushteve për shlyerje nga paragrafi 16 të këtij neni dhe dorëzon propozim te drejtori i cili miraton vendim për shlyerjen e personave profesionalë nga Regjistri.

Fondi do ta shlyejë personin nga Regjistri i personave profesionalë nëse:

- atë vetë e kërkon,
- jep mendim joprofesional, respektivisht të njëjtën e përgatit në kundërshtim me rregullat e shkencës dhe profesionit, standardet profesional dhe rregullat për parandalimin e konfliktit të interesave,
- personi nuk dorëzon mendim sipas materialeve të marra në afatin e përcaktuar të këtij neni ose
- për shkak të vdekjes së personit.

Personi profesional i cili do të shlyet nga Regjistri në rastet e theksuara në paragrafin 16 alinetë 2 dhe 3 të këtij neni, nuk do të mund sërish të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë.

Mënyra e mbajtjes së Regjistrit për regjistrimin e shlyerjes së personave profesionalë përcaktohet me rregullore të cilën e miraton Këshilli Drejtues i Fondit.

#### **Neni 25-b**

Fondi kryen ndjekje dhe evaluim të projektit për të cilën i janë ndarë mjete, me qëllim të zhvillimit të shoqërisë së sipërmarrësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë ndjekjes dhe evaluimit për projektet nga paragrafi 1 të këtij neni, Fondi mund të angazhojë persona profesionalë për revizion nga Regjistri i personave profesionalë për revizion nga sfera adekuate nga paragrafi 14 të këtij neni të bëhet evaluim dhe të japin mendim profesional.

Personi profesional për revizion është i obliguar të shqyrtojë material, me kërkesë të Fondit të kryejë vizitë në terren tek shfrytëzuesi i mjeteve nga Fondi dhe të dorëzojë raport dhe mendim profesional në afat prej 14 ditë pune nga dita e marrjes së ftesës nga Fondi.

Në shtojcë të këtij mendimi, personi profesional dorëzon deklarata për revizionin nën përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale se mendimi është punuar në mënyrë profesionale dhe me vetëdije, në pajtim me rregullat e shkencës dhe profesionit, normave etike dhe profesionale.

Personat profesionalë kanë të drejtë të kompensimit për evaluimit të bërë dhe vizitës së kryer në terren dhe mendimin e dhënë profesional që është në ngarkim të Fondit në shumë që përcaktohet me listë tarifore që e miraton Këshilli Drejtues i Fondit, kurse me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 5 të këtij neni përcaktohet sipas, vlerësimit të përcaktuar të marrëveshjes.

Mënyra e përfshirjes dhe puna e personave profesionalë për revizion në punën e Fondit gjatë evaluimit dhe dhënies së mendimit profesional rregullohet me rregullore të cilën e miraton Këshilli Drejtues i Fondit.

Fondi themelon dhe mban Regjistër elektronik të personave profesionalë të cilët i ndihmojnë gjatë evaluimit dhe dhënies së mendimit profesional. Të dhënat personale të personave profesionalë të cilët do të evidentohen në Regjistrin e personave profesionalë për revizion janë: emri dhe mbiemri, data dhe vendlindja, shtetësia, adresa e jetesës,

kontakt telefoni, adresa elektronike, sfera e specializimit, të dhëna për arsim të mbaruar dhe përvojë pune Afati për ruajtjen e të dhënave personale është tre vjet duke llogaritur nga dita e njoftimit për shlyerje nga Regjistri i personave profesionalë për revizion.

Për regjistrim në Regjistrin e personave profesionalë për revizion Fondi publikon thirrje publike në të cilën përcaktohen sferat e specializimit, kushtet për zgjedhje, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjeve, dokumentacioni i nevojshëm për dëshmimin e plotësimit të kushteve për zgjedhje dhe elemente tjera që i përcakton Këshilli Drejtues i Fondit.

Që të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë për revizion, personi duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- të ketë së paku arsim të lartë në sferën përkatëse,
- të ketë njohje të gjuhës angleze dhe
- të ketë së paku shtatë vjet përvojë pune në sferën përkatëse për të cilën është parashtruar kërkesa.

Përvoja ndërkombëtare në sferën e specializimit dhe përvoja në zbatimin e analizës esenciale do të konsiderohet përparësi gjatë regjistrimit në Regjistrin e personave profesionalë për revizion.

Drejtori i Fondit formon Komision për zgjedhjen e personave profesionalë për revizion nga më së paku tre nga radhët e të punësuarve nga të cilët njëri është kryetar, i cili e përcakton plotësimin e kushteve për regjistrim nga paragrafi 10 të këtij neni dhe dorëzon propozim te drejtori i cili miraton vendim për zgjedhje dhe regjistrim të personave profesionalë për revizion në Regjistër.

Para lidhjes së marrëveshjes me personat profesionalë për revizion dhe regjistrim të tyre në Regjistrin e personave profesionalë për revizion, Komisioni për zgjedhjen e personave profesionalë mund të zbatojë kontroll plotësues dhe intervista me kandidatët e paraqitur.

Personat profesionalë për revizion regjistrohen në Regjistrin për persona profesionalë për revizion sipas sferave të specializimit të cilat i përcakton Këshilli Drejtues i Fondit.

Një person mund të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë në më shumë sfera të specializimit.

Fondi do ta shlyejë personin nga Regjistri i personave profesionalë për revizion, nëse:

- atë vetë e kërkon,
- jep mendim joprofesional, respektivisht të njëjtën e përgatit në kundërshtim me rregullat e shkencës dhe profesionit, standardet profesional dhe rregullat për parandalimin e konfliktit të interesave,
- personi nuk dorëzon mendim sipas materialeve të marra në afatin e përcaktuar në këtë

nen ose

- për shkak të vdekjes së personit.

Drejtori i Fondit formon Komision për shlyerjen e personave profesionalë për revizion nga më së paku tre nga radhët e të punësuarve nga të cilët njëri është kryetar, i cili e përcakton plotësimin e kushteve për shlyerje nga paragrafi 16 të këtij neni dhe dorëzon propozim te drejtori i cili miraton vendim për shlyerjen e personave profesionalë për revizion nga Regjistri.

Personi profesional për revizion i cili do të shlyhet nga Regjistri në rastet e theksuara në paragrafin 16 alinetë 2 dhe 3 të këtij neni, nuk do mund sërish të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë për revizion.

Mënyra e mbajtjes së Regjistrit për regjistrimin dhe shlyerjen e personave profesionalë për revizion përcaktohet me rregullore të cilën e miraton Këshilli Drejtues i Fondit.

Personat të cilët janë regjistruar në Regjistrin e personave profesionalë nuk mund të regjistrohen në Regjistrin për persona profesionalë për revizion.

## **Të hyra të Fondit**

### **Neni 26**

Të hyrat e Fondit realizohen nga:

- mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- mjete në shumë prej 1% nga mjetet e përgjithshme nga Programi për përkrahje financiare të zhvillim rural,
- Mjete tjera nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural në shumën e përcaktuar në alinenë 2 nga ky paragraf, në lartësi të mjeteve të përcaktuara në Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural, për inovacione, hulumtim dhe zhvillim, transfer të teknologjive, ekstension teknologjik, akceleratorë afaristë-teknologjikë nga sfera e bujqësisë, pylltarisë, ekonomisë së ujërave dhe zhvillimit rural,
- donacione, kontribute, dhurata dhe ndihma,
- të hyra (rojalte),
- mjete të realizuara në bazë të shitjes së pjesëmarrjeve të cilat fondi për investime ekvite dhe mezanin dhe/ose fondi privat i posedon në shoqëri tregtare,
- të hyra të realizuara në bazë të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral ndërkombëtar të programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera në sferën e veprimtarisë së inovacioneve,
- të hyra nga menaxhimi me mjetet e lira monetare të Fondit dhe
- burime tjera, në pajtim me ligjin.

## **Përdorimi i mjeteve të Fondit**

## Neni 27

Në kryerjen e punëve të veta, e posaçërisht në planifikimin dhe shfrytëzimin e mjeteve, Fondi i zbaton parimet e objektivitetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punë dhe marrjen e vendimeve.

Mjetet e Fondit shfrytëzohen për financimin e veprimtarisë së inovacioneve, e posaçërisht për:

- investime në realizimin dhe plasmanin e inovacioneve të orientuara të tregut të shoqërive tregtare të sapo themeluara,
- nxitjen e inovacionit në sferat me prioritet nga shkenca dhe teknologjia në pajtim me Strategjinë për inovacione dhe
- realizimin e veprimtarisë së Fondit.

Fondi mund të marrë pjesë edhe në kofinancimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve tjera për dedikimet nga paragrafi 2 i këtij neni, nëse i organizojnë dhe financojnë organizatat ndërkombëtare, institucionet dhe trupat financiare ose persona tjerë juridike dhe fizike të huaj dhe të vendit.

## Programe të Fondit

## Neni 28

Fondi:

- miraton program vjetor dhe afatmesëm për punë, për periudhën prej tre vitesh,
- përcakton llogari periodike dhe vjetore dhe raport të revizionit,
- miraton plan financiar,
- e ndjek realizimin e programit dhe kryen mbikëqyrje mbi përdorimin racional të mjeteve nga shfrytëzuesit e mjeteve dhe
- vendos për çështje tjera dhe kryen punë tjera të përcaktuara me statutin e Fondit.

Për programin vjetor dhe afatmesëm të punës së Fondit, si dhe llogarinë vjetore për punën e Fondit dhe raportin e revizorit, pëlqim jep Qeveria.

Këshilli Drejtues dorëzon për miratim në Qeveri raport për realizimin e programit të punës për vitin e kaluar, më së voni deri më 15 janar në vitin rrjedhës.

Këshilli Drejtues dorëzon për miratim në Qeveri raport për realizimin e programit afatmesëm të punës, më së voni deri më 15 janar pas kalimit të vitit të tretë.

Këshilli Drejtues është i obliguar që të dorëzojë raport për punën e vet në periudhë tjetër, të ndryshme nga periudhat nga paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, me kërkesë të Qeverisë.

## Organet e Fondit

### Neni 29

Organe të Fondit janë: Këshilli Drejtues, Komiteti për Aprovimin e Investimeve dhe drejtori.

Anëtarët e Këshillit Drejtues i emëron dhe shkarkon Qeveria.

Anëtarët e Komitetit për Aprovimin e Investimeve i emëron dhe shkarkon Qeveria.

### Këshilli Drejtues

#### Neni 30

Këshilli Drejtues ka kryetar dhe gjashtë anëtarë.

Kryetarin e Këshillit Drejtues, nga radhët e anëtarëve të Këshillit Drejtues, e emëron Qeveria me propozim të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Anëtarët e Këshillit Drejtues i emëron Qeveria si profesioniste të dalluar me së paku pesë vite përvojë pune nga sfera e ekonomisë, financave, drejtësisë, investimeve ose veprimtaria e inovacioneve, me së paku arsim të lartë të përfunduar dhe ta njohin gjuhën angleze.

Tre anëtarë të Këshillit drejtues emërohen për periudhë prej dy viteve, kurse katër anëtarë emërohen për periudhë prej tre viteve, me qëllim që të mbahet vazhdimësia e punës së Këshillit drejtues. Kohëzgjatjen e mandatit të secilit prej anëtarëve të Këshillit drejtues e përcakton Qeveria në aktin për emërim.

Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të jenë persona të punësuar në Fond.

Këshilli drejtues i kryen punët në vijim:

- e përcjell realizimin e programeve të Fondit,
- e përcjell punën e rregullt të fondit,
- miraton Statut të Fondit,
- e miraton programin afatshkurtër dhe afatmesëm për punë, planin financiar dhe raportin vjetor për punën e Fondit të cilat i parashtron me pëlqim të Qeverisë,
- e miraton llogarinë vjetore dhe raportin e revizionit të Fondit,
- e miraton raportin e drejtorit për realizim të programit të Fondit,
- shqyrton çështje, raporte, informata dhe materiale tjera në lidhje me gjendjet dhe problemet nga veprimtaria investuese,
- merr pjesë në përcaktimin e zhvillimit të veprimtarisë inovative dhe punën e Komitetit

për inovacione dhe sipërmarrësi,

- zgjedh revizor të autorizuar,

- vendos për organizim të zyrave të Fondit, numrin e tyre, lokacionet dhe shuarjen, me propozim të drejtorit të Fondit.

- shpallje të konkursit publik për zgjedhje të drejtorit të Fondit,

- jep mendim paraprak për zgjedhje dhe shkarkim të drejtorit të Fondit dhe

- vendos edhe për çështje tjera në pajtim me këtë ligj dhe Statutin e Fondit.

Këshilli Drejtues vendos në mbledhje. Vendimet konsiderohen të miratuara nëse për ato kanë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues mund të kryejë mbikëqyrje në librat afariste ose dokumentacionin afarist të Fondit.

Anëtarët e Këshillit Drejtues gjatë realizimit të punës doemos duhet të veprojnë me vëmendje të detyruar dhe t'i mbrojnë sekretet afariste të Fondit.

Drejtori, me kërkesë të Këshillit Drejtues, parashtron raport për punë të veçanta të lidhura me menaxhimin e mjeteve me dedikim, përkatësisht për kërkesa tjera lidhur me punën e Fondit.

Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues u takon kompensim mujor për punë në Këshillin Drejtues, lartësinë e të cilit e përcakton Qeveria, i cili paguhet nëse gjatë muajit ka mbajtur së paku një mbledhje dhe vetëm kryetarit dhe anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje, përkatësisht mbledhjet e Këshillit Drejtues.

Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen nga Qeveria edhe para kalimit të mandatit për të cilin janë emëruar.

## **Komiteti për Aprovimin e Investimeve**

### **Neni 31**

Komiteti për Aprovimin e Investimeve ka pesë anëtarë të cilët i zgjedh Qeveria nga radhët e ekspertëve me së paku përvojë dhjetëvjeçare ndërkombëtare nga sfera e investimeve në veprimtarinë e inovacioneve. Nga radhët e anëtarëve, Qeveria përcakton kryetarin e Komitetit për miratimin e investimeve.

Anëtarët e Komitetit për Aprovimin e Investimeve zgjidhen nën kushte dhe kritere të përcaktuara në konkurs ndërkombëtar.

Konkursin ndërkombëtar për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit nga paragrafi 1 i këtij neni e shpall Këshilli Drejtues gjashtë muaj para kalimit të mandatit të anëtarëve të Komitetit.

Dy anëtarë të Komitetit emërohen për periudhë prej dy viteve, tre anëtarë të Komitetit emërohen për periudhë prej tre viteve, me qëllim që të mbahet kontinuiteti i punës së Komitetit. Kohëzgjatjen e mandatit të secilit prej anëtarëve të Komitetit e përcakton Qeveria.

Komiteti për Aprovimin e Investimeve mban së paku një takim gjatë secilës thirrje publike për ndarjen e mjeteve.

Kryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Aprovimin e Investimeve u takon kompensim pas evaluimit të pilot projekteve, përgatitje dhe pjesëmarrje në mbledhje të Komitetit, lartësinë e të cilit e përcakton Qeveria. Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për miratimin e investimeve u paguhen edhe mjete për shpenzimet e bëra rrugore (bileta aeroplani ose bileta për lloj tjetër të transportit, transporti prej dhe deri te aeroport), shpenzime për vendosje dhe ushqim gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në shtet.

Shpenzimet për vendosje dhe ushqim gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në shtet i përcakton Këshilli drejtues i Fondit.

Komiteti i shqyrton dhe lejon propozim-projektet të dorëzuara në të për të gjitha instrumentet për mbështetjen e Fondit në pajtim me nenin 25 të këtij ligji.

Komiteti merr vendim për ndarjen e instrumenteve të mbështetjes në afat prej 90 ditë nga dorëzimi i propozim - projekteve te Komiteti.

Anëtarët e Komitetit miratojnë vendim përfundimtar për financim nëpërmjet votimit. Vendimi përfundimtar për financim miratohet me shumicë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komitetit.

Anëtarët e Komitetit përgjigjen ndaj Fondit për dëmin e shkaktuar për shkak të punës së tyre të pandërgjegjshme ose të paligjshme.

Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen nga Qeveria edhe para kalimit të mandatit për të cilin janë emëruar.

**Drejtori**

**Neni 32**

Drejtori i Fondit zgjidhet nëpërmjet konkursit publik, e cila botohet në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra nga gazetatat që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Konkursin publik për zgjedhjen e drejtorit e shpall Këshilli Drejtues.

Afati për paraqitjen në konkursin publik nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e publikimit në gazetatat ditore.

Këshilli Drejtues dorëzon në Qeveri propozim për drejtor të Fondit.

Drejtori zgjidhet për periudhë prej katër vitesh dhe mund të zgjidhet përsëri vetëm edhe një mandat.

Për drejtor të Fondit mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtari ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose të mbaruar shkallën VII/1 nga sfera e shkencave ekonomike ose teknike teknologjike;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në lëmi dhe
- 5) posedon një nga certifikatat e pranuar ndërkombëtare vijuese ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
  - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
  - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
  - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
  - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë,
  - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
  - APTIS (APTIS)- së paku niveli B2 (B2).

## **Procedura për zgjedhjen e drejtorit**

### **Neni 33**

Konkursin zgjedhje publike e përgatit dhe shpall Këshilli Drejtues më së paku 60 ditë para kalimit të mandatit të drejtorit.

Verifikim formal të kërkesave të arritura kryen person i autorizuar nga Këshilli Drejtues i cili përgatit listë të fletëparaqitjeve që kanë arritur dhe e parashtron në shqyrtim te Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues pas shqyrtimit të fletëparaqitjeve të plota dhe të arritura në kohë dhe intervistave personale të realizuara paraprakisht me kandidatet potenciale, formon mendim të cilin e dorëzon te Qeveria së bashku me fletëparaqitjet që kanë arritur.

Qeveria, në bazë të propozimit të Këshillit Drejtues, merr vendim për zgjedhjen e drejtorit të Fondit i cili shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

## **Autorizime, obligime dhe përgjegjësi të drejtorit**

### **Neni 34**

Drejtori i Fondit në suazat e të drejtave dhe obligimeve të veta të caktuara me këtë ligj:

- udhëheq me Fondin dhe e përfaqëson dhe prezanton Fondin para personave të tretë,
- kujdeset për realizimin e programeve të Fondit,
- kujdeset për punën e rregullt të Fondit,
- i propozon bazat e programit vjetor dhe afatmesëm për punë dhe ndërmerr masa për zbatimin e tyre,
- propozon te Këshilli drejtues akte të përgjithshme për organizim, sistematizim dhe akte tjera të përgjithshme të lidhura me punën e Fondit,
- propozon te Këshilli drejtues organizim të zyrave të Fondit, numrin e tyre, lokacionet dhe shuarjen,
- propozon shoqëri për revizion te Këshilli drejtues të bazuar në furnizimin publik,
- parashtron raport për realizimin e programit të Fondit për vitin e kaluar në Këshillin drejtues,
- parashtron raport për punën e Fondit për vitin e kaluar në Këshillin drejtues,
- parashtron propozim-plan financiar për vitin që vijon dhe Program vjetor te Këshilli Drejtues,
- organizon dhe siguron kryerje ligjore dhe efikase të punëve nga fushëveprimi i Fondit dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punën e Fondit,
- Këshillit drejtues i parashtron raporte dhe analiza për çështje nga fushëveprimi i Fondit dhe jep propozime për zgjidhjen e çështjeve për të cilat vendos Këshilli drejtues,
- kujdeset për zbatimin e vendimeve, udhëzimeve dhe konkluzioneve të miratuara të Këshillit drejtues të Fondit,
- e organizon dhe koordinon punën e të punësuarve në Fondin dhe vendos për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre të marrëdhënies së punës, në pajtim me ligjet dhe rregullat tjera të marrëdhënies së punës dhe marrëveshjeve kolektive,
- themelon komisione dhe trupa tjerë punues për çështje nga kompetenca e vet,
- merr pjesë në punën e Komitetit për inovacione dhe sipërmarrësi pa të drejtë të votës dhe
- kryen edhe punë tjera të cilat me ligj, statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të cilat janë në kompetencë të vet.

Gjatë realizimit të punës së vet, drejtori është i obliguar që t'i mbrojë sekretet afariste të Fondit.

Drejtori është kompetent për ligjshmërinë e punës së Fondit.

Drejtori përgjigjet ndaj Fondit për dëmin e shkaktuar për shkak të punës së tij të pandërgjegjshme ose të paligjshme.

## **Shkarkimi para kohe**

### **Neni 35**

Këshilli Drejtues, me pëlqim paraprak nga Qeveria mund ta shkarkoje drejtorin:

- me kërkesë të tij,
- nëse ndodh ndonjëra nga arsyet për shkak të të cilave sipas rregullave për marrëdhënie të punës, i ndërpritet marrëdhënia e punës me fuqi të ligjit,
- nëse nuk vepron sipas ligjit, Statutit dhe akteve të përgjithshme të Fondit ose pa arsye nuk i zbaton vendimet e Këshillit Drejtues ose vepron në kundërshtim me ato,
- nëse me punën e vet të pandërgjegjshme dhe të parregullt i shkakton Fondit dëm të rëndësishëm apo nëse i anashkalon ose nuk i realizon obligimet e veta dhe për shkak të kësaj ndodhin ose mund të ndodhin çrregullime të rënda në veprimtarinë e Fondit,
- nëse e pengon ose në mënyrë tjetër e pamundëson realizimin e të drejtave dhe obligimeve të shfrytëzuesve të instrumenteve për mbështetje dhe
- nëse punon në kundërshtim me ligjin.

Nëse ndodhin ndonjëra nga arsyet nga paragrafi 1 i këtij neni, funksionin drejtor e kryen ushtruesi i detyrës drejtor deri në zgjedhjen e drejtorit, e më së shumti deri në gjashtë muaj.

Nëse edhe në afatin nga paragrafi 2 i këtij neni nuk zgjidhet drejtori, ushtruesi i detyrës drejtor mund të emërohet edhe për gjashtë muaj.

Ushtruesin e detyrës drejtor e emëron Qeveria me propozim të Këshillit Drejtues.

## **Transparenca e punës së Fondit**

### **Neni 36**

Puna e Fondit është transparente.

Fondi në kohë dhe saktësisht e njofton publikun për kryerjen e veprimtarisë për të cilën është themeluar, nëpërmjet ueb faqes së vet, në mënyrë të përcaktuar me statutin e Fondit.

Me kërkesë të publikut Fondi jep informata për kryerjen e punëve nga veprimtaria e vet, në pajtim me Ligjin për qasje të lirë të informatat me karakter publik.

## **Kryerje e punëve profesionale dhe punëve tjera**

### **Neni 37**

Punët profesionale dhe punët administrative teknike i kryejnë të punësuarit në Fond.

Për të punësuarit në Fond të cilat kryejnë punë administrative zbatohen dispozitat nga Ligji për nëpunës administrativë dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, kurse për të punësuarit që kryejnë punë ndihmëse teknike zbatohen dispozitat nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe Ligji për marrëdhënie pune.

Mjetet për pagë, shtojca të pagës dhe kompensime tjera të të punësuarve në Fond janë përcaktuar me planin vjetor financiar të Fondit dhe të njëjtat doemos duhet të jenë në lartësi të përafërt me pagat në sektorin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Mënyrën e përcaktimit të pagës themelore dhe të shtojcave të pagës së të punësuarve në Fond dhe vlerën e pikës së pagës themelore e rregullon Këshilli drejtues i Fondit pas pëlqimit paraprak të Qeverisë.

## **Konflikti i interesave**

### **Neni 38**

Në rast të ekzistimit të konflikt të interesave gjatë ndarjes të mjeteve në pajtim me ligjin, zbatohet Ligji për parandalimin e konflikteve të interesave.

## **VI. FONDI I INVESTIMEVE EKVITE DHE MEZANIN DHE FONDI PRIVAT**

### **Themelimi dhe regjistrimi i Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin**

#### **Neni 39**

Fondi i Investimeve Ekvite dhe Mezanin themelohet nga Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik.

Fondi i Investimeve Ekvite dhe Mezanin regjistrohet në Regjistrin e fondeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që mbahet në Komisionin e Letrave me Vlerë, ndërsa fletëparaqitjen për regjistrim e parashtrona Fondi për Inovacion dhe Zhvillimin Teknologjik.

Madhësia e Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin është së paku 300.000 euro në kundërvlerë me denarë.

Në Fondin e Investimeve Ekvite dhe Mezanin nuk zbatohet dispozitat nga Ligji për fondet investuese.

### **Shoqëria për menaxhim me Fondin e Investimeve Ekvite dhe Mezanin**

#### **Neni 40**

Me Fondin e Investimeve Ekvite dhe Mezanin menaxhon Shoqëria për Menaxhim me Fonde Private, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara në Ligjin për fonde investuese.

Me përjashtim të dispozitave nga Ligji për fonde investuese, statutin dhe prospektin e Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin i miraton Fondi.

### **Statuti i Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin**

#### **Neni 41**

Me statutin e Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin, rregullohet puna e tij, pozita juridike e pronarëve të dokumenteve për pjesëmarrje, marrëdhëniet juridike të Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin me Shoqërinë për Menaxhim, si dhe çështje tjera me interes për realizimin e qëllimeve të Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin.

### **Prospekti i fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin**

#### **Neni 42**

Prospekti i Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin përmban të dhëna nga statuti, informacione të detajuara dhe të dhëna për qëllimet dhe politikën si dhe informacionë tjera që kanë të bëjnë me Fondin e Investimeve Ekvite dhe Mezanin, e që mund të ndikojnë në vendimin e investitorëve për investime.

### **Raportet financiare të Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin**

#### **Neni 43**

Fondi i Investimeve Ekvite dhe Mezanin i nënshtrohet revizionit.

Raporti i revizionit të kryer, menjëherë pas marrjes, Shoqëria për Menaxhim e dorëzon të Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, së bashku me raportin financiar dhe raportin vjetor për punë të Fondit të Investimeve Ekvite dhe Mezanin.

## **Përkrahja për formimin e fondeve private**

### **Neni 44**

Fondi mundet të investojë mjete edhe në fonde private, në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me Ligjin për fonde investuese.

Investimi i mjeteve nga ana e Fondit është në formë të investimit të kapitalit në fond ekzistues privat ose për formimin e fondit privat, por jo më tepër se një e treta e madhësisë së përgjithshme të fondit privat.

Fondi mund të ofrojë stimulime plotësuese për tërheqjen e investitorëve në fondet private. Stimulimet plotësuese kanë të bëjnë me dhënien e të drejtave të privilegjuara investitorëve lidhur me mbrojtjen e pjesës nga humbja e mjeteve të investuara, dhënien e të drejtave të privilegjuara investitorëve në aspekt të garantimit të kthimit prioritar të mjeteve të investuara dhe/ose garantimit të shkallës së privilegjuar të kthimit të mjeteve investuara.

## **VII. MASA STIMULUESE EKONOMIKE**

### **Neni 45**

Subjektet e veprimtarisë së inovacionit, të regjistruara në bazën nga neni 16 të këtij ligji, janë të lira nga detyrimet doganore për import të pajisjes së dedikuar për veprimtari hulumtuese shkencore dhe të inovacionit, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara në rregullat nga sfera e punës doganore.

## **VIII. MBIKËQYRJA**

### **Neni 46**

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Ministria.

Mbikëqyrje mbi punën e financimit të Fondit, për mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryen Enti Shtetëror për Revizion.

Fondi obligohet që një herë në vit të kryejë revizion me zgjedhje të Shoqërisë për Revizion.

Raportin e revizionit Shtetëror për Revizion e dorëzon në Fond dhe në Qeveri.

Mbikëqyrje e drejtpërdrejtë mbi punën financiare për mjetet nga organizatat, institucionet dhe trupat financiare ndërkombëtare dhe trupa dhe persona tjerë të huaj dhe vendas

juridike dhe fizike, kryhet me në mënyrë të kontraktuar ndërmjet Fondit dhe dhënësve të mjeteve financiare.

## **IX. DISPOZITA NDËSHKUESE**

### **Neni 47**

Kryetari dhe anëtari i Komisionit për Miratimin e Investimeve që nuk do të veprojë në pajtim me afatet e këtij ligji dhe nenin 31 paragrafi 8 të këtij ligji, do të përgjigjet penalisht dhe do të dënohet me dënim në para në shumë prej 5.000 deri në 10.000 euro në kundërvlerë me denarë.

## **X. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 48**

Kryetarin dhe anëtarët e Këshilli Drejtues të Fondit, kryetarin dhe anëtarët e Komitetit për Aprovimin e Investimeve dhe të Komitetit për Sipërmarrësi dhe Inovacione, Qeveria do t'i emërojë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Fondi do të fillojë me punë me ditën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Qeveria, deri në zgjedhjen e drejtorit të Fondit, emëron ushtrues detyrë të drejtorit në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Këshilli Drejtues në afat prej 30 ditëve nga dita e konstituimit të tij do të miratojë statut të Fondit.

Këshilli Drejtues në afat prej 30 ditësh nga dita e konstituimit të tij do t'i miratojë aktet për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në Fond.

### **Neni 49**

Dispozita e nenit 45 të këtij ligji do të zbatohet deri në aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

### **Neni 50**

Aktet nënligjore të parapara në këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 51**

Procedurat e filluara sipas dispozitave të Ligjit për nxitje dhe ndihmë të zhvillimit teknologjik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 47/11) para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të mbarojnë në pajtim me Ligjin për nxitje dhe ndihmë të zhvillimit teknologjik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 47/11).

#### **Neni 52**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për nxitje dhe ndihmë të zhvillimit teknologjik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 47/11).

#### **Neni 53**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### **DISPOZITA NGA LIGJET PËR NDRYSHIM DHE/OSE PLOTËSIM**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

#### **Neni 4**

Drejtori i Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të nenit 2 të këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

#### **Neni 6**

Dispozitat nga neni 2 nga ky ligj do të fillojnë të zbatohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj që do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat nga neni 3 i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligji për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2016):

#### **Neni 21**

Rregullat nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 90 ditëve nga

dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 22**

Personat profesionalë për revizion të përcaktuar në nenin 25-a të këtij ligji do të bëjnë evaluim të projekteve të ndara në pajtim me Ligjin për veprimtari inovative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 79/13, 137/13, 41/14 dhe 44/15).

#### **Neni 23**

Procedurat e filluara për ndarjen e mjeteve për instrumentet për mbështetje deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundohen sipas dispozitave të këtij ligji.

#### **Neni 24**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji Komiteti për sipërmarrësi dhe inovacione për përcjelljen e zhvillimit dhe eksploatimit komercial të inovacioneve vazhdon të punojë si Komitet për inovacione dhe sipërmarrësi.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/2016):

#### **Neni 26**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse dispozitat e nenit 19 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 shtatori 2016.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2016):

#### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

#### **Neni 2**

Dispozitat e nenit 32 paragrafi (6) pika 5) të Ligjit për veprimtari Inovative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 79/13, 137/13, 41/14, 44/15, 6/16, 53/16 dhe 190/16) dhe dispozitat e nenit 1 të këtij ligji, me të cilin plotësohet neni 32 paragrafi (6) pika 5) me aline të re 6, nuk do të zbatohet nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2018):

#### **Neni 3**

Drejtori i zgjedhur në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018 është i detyruar të plotësojë kërkesën për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e zgjedhjes së tij.

Drejtorit, i cili nuk do të plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/2024):

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".